

Abdullah Thaçi
NJË MAL ME KËNGË

Biblioteka:
LASGUSHI

Redaktor:
Sali Bashota

Lektor:
Musa Bushrani

Ballina:
Përzgjedhje e autorit

Abdullah Thaçi

NJË MAL ME KËNGË


Vjersha për fëmijë

Shtëpia botuese

R O Z A F A

Prishtinë

2009



Çdo orë e kurdisur
është ngapak e krisur
nuk ndalet tërë jetën
e përsërit vetveten

AGU

Yjet fik me rend,
territ s'i lë vend.

End fillin e artë,
dielli top i zjarrtë.

Zor të ketë mbetur,
zog a fëmijë fjetur.

Zjen puna dhe loja,
Bilbil, të lumtë goja!

Dita hyn ngadalë,
Portës triumfale...

Rrjedh përroi malor,
shket treni jetësor.

Muzgu kur avitet,
kjo lojë përsëritet.

Sipas këngës vjetër,
çdo sot, bëhet - nesër

SUPRNINULLË

Nina - nana
nina - nana

Nina nana ngrykun plot
nina - nana
Dorë të lehtë pastë mamia
nina - nana
Mos të pezmatoftë kërthiza
nina - nana
Paç për vete gjinjtë e nënës
nina - nana
Mos të pafhtë syri i keq
nina - nana
T'u shtroftë udha me urata
nina - nana
U bëfsh plak pa u plakur kurrë

Nina - nana
nina paç!

KUR TË RRITEM

Jam një çupë e vogël fare,
kam pianon gjashtë vjeçare,
sapo dëgjojnë melodinë,
vijne bilbilat në dritare,
me shoqërojnë me violinë.

Vijne bilbilat
në dritare...

Jam e vogël, jam e madhe,
s'i lakmoj as t'brit t'mbretit,
mësuese e kam një sorkadhe,
m'i mëson numrat e baletit.

Mësuese e kam
një sorkadhe...

Jam e vogël...Kur të rritem,
si një primabalerinë,
nëpër skena do të ngjitem,
në Tiranë e në Prishtinë.

Nëpër skena
do të ngjitem...

Pritmë, veç pak sa të rritem...

NJË, SI ZOTI

50 %
më je
Atdhe

50 %
më je
Mëmëdhe

100 %
më je
Imdhe

Të paça,
të daça
kështu si je!

KJO LUZMË FJALËSH

Në fillim ishte fjala,
brigjet i spërkatte vala.

Si një Marigo e dytë,
fjalët qëndisën fjalitë.

Fjalitë stisën periudhën,
kalorësit kaptuan udhën.

Udhën që të shpie drejt
për në Olimpin e Shenjtë.

Atje ku kjo luzmë fjalësh,
prarohet me ozon malesh.

LIBRI QË NUK RIBOTOHET

Këtë kalin e jetës
e shalojmë me vrap.
Zoti na e fali
që t'ia kthejmë prapë.

Kësaj lules së jetës
që na sjell beharin,
me zellin e bletës
ia thithim nektarin.

Këtë lisin e jetës,
me rrënjë e me pipa,
e mbëltuan gjyshërit,
e kultivojnë nipat.

Ky libri i jetës,
që nuk ribotohet,
vetëm një herë shkruhet,
njëmijë herë lexohet...

VAPOR NË DY DETE

Për dikë je – Vlorë,
për dikë je - Vlonë,
për të gjithë themel
i Kështjellës sonë.

Në dorën që i lidhi
tokën, qiellin, detin,
qëndismë e Marigosë
flakëron Monumentin.

S'pat faj baci Isë
pak vonë kishte ardhë,
në dasmën q'e grishi
Plaku mjekërbardhë.

Deshën të të djegin,
por s'të dogjën dot!
Vapor në dy dete,
mbete jetë e mot.

ZOG - ZOGU

Zog bir zogu - zogu ishte,
s'ka si ndryshe për të qenë.

Gjysh e gjyshe zogj i kishte,
zogj i kishte - babë e nënë.

E lexoi zogu këtë vjershë,
për origjinën e të parëve...

U ngrëfos e po buzëqesh:
“Zogu – Zog!
Mbret i shqiptarëve!”

PSE S'I THONË PARAJSË

Nëse Ulqini paska det,
pse nuk quhet deti – Ulqin?

Nëse Dukagjini paska shëndet,
pse nuk quhet shëndeti - Dukagjin?

Nëse Gadimja paska mermer,
pse nuk quhet mermeri – Gadime?

Nëse Mirusha paska ylber
pse nuk quhet ylberi – Mirushë?

Nëse Rugova si nënë të përkëdhel,
pse nuk quhet Rugova – kolovajzë?

Nëse Kosova paska kaq shumë engjëj,
pse nuk quhet Kosova – Parajsë?

ENGJËLL I PERËNDISË

Njëfish e dua – nurin e nanës
Dyfish e dua - gruan e babës
Trefish e dua - renë e tim gjysh
Bijën e dajëve - e dua katërfish
Pesëfish e dua - vjehrrën e sime grua
Gjyshen e tim bir - gjashtëfish e dua
Shtatëfish e dua - bukëdhënësen bujare
Tetëfish e dua - veshjen kombëtare
Nëntëfish e dua - zonjën e shtëpisë
Dhjetëfish e dua - Engjëllin e Perëndisë!

Ç'FAJ TË KAM, BABA?

Se a mos i thashë
mua që më lindi?
Të më sjell në jetë, se a mos i thashë?

Vetë e kishte rritur
këtë fikus prindi,
si fryt dashurie, para së gjithash.

Se a mos i thashë
në luftë të shkonte,
të plagosej rëndë, se a mos i thashë?

Me të kuqtë e zemrës
vetë e vizatonte
hartën e Atdheut, para së gjithash.

Se a mos i thashë
herët të thinjet,
të plaket herët, se a mos i thashë?

Në pemën e fisit
i numëronte lindjet,
ëndrrat e moçme, para së gjithash.

SYPRINA NË MES

Me kokën nën ujë,
japin shpirt – njerëzit!

Me kokën mbi ujë,
japin shpirt – peshqit!

Dy poet e jetës
i ndan një syprinë.

Dikujt –
fat i sjell,
dikujt –
tragjedinë!

LOTËT

Ka lot të ftohtë...
Ka lot të ngrohtë...

Lotët e mërzisë
të njelmët,
të njelmët,
të njelmët,
nga kripa e hidhërimit!

Lotët e lumturisë
të ëmbël,
të ëmbël,
të ëmbël,
nga mjalti i gëzimit!

Ka lot kaq të ngrohtë!
Ka lot kaq të ftohtë!

Nga të njëjtit sy
rrjedhin...

PA LETËR E PËRGAMENË

Në fillim fare,
ishte leximi,
kur ende nuk dihej as shkrimi.

Sekush lexonte
në mënyrën e vet,
kur ende nuk ishte asnjë alfabet.

I lashtë sa njeriu
leximi kishte qenë,
kur nuk kishte letër as pergamenë.

Lexoheshin fjalët, tipat, karakteret,
natyra, mendimet, grimasat, aferat.

Ëndrrat, streset, dukuritë, gjendjet,
krizat, lojërat, arritjet, mbamendjet.

Në fillim fare,
në fillim të fillimit,
në shkollë mësohej
veç lënda e leximit!

SHTETAS PA STATUS

Çfarë statusi kanë
njerëzit e palindur?

As nuk janë fëmijë,
as nuk janë të rritur.

As nuk janë të rinj,
as nuk janë të vjetër.

Nuk janë në këtë botë,
as në botën tjetër.

S'kanë emra, mbiemra,
shtet as vendbanim.

S'kanë as dokumente
për identifikim.

Askush nuk i pyet,
askush s'i dëgjon...

Pa të drejtë vote,
pa punë, pa pension!

Mos janë të burgosur?
Parazitë mos janë?

Me këmbë t'huaja ecin,
me gojë të huaj hanë...

Këta banorë t'Planetit,
pa kurrfarë të dhënash,

Mos janë, gonxhe jete,
çelur në zemra nënash?!

KUR JE MË VARFANJAK

Si thua, ti vocërrak,
kur je më varfanjak?

Kur të mungon - pasuria
Kur të mungon - dituria
Kur të mungon - liria
Kur të mungon - pavarësia
Kur të mungon - simpatia
Kur të mungon - dashuria
apo

Kur të mungon – motivimi
Kur të mungon – vetëbesimi
Kur të mungon – adhurimi
Kur të mungon – inspirimi
Kur të mungon – përkushtimi
Kur të mungon – insistimi

Si thua, ti vogëlush,
a t'i di hallet ndokush?!

ZOGU I ZEMRËS

Si i përtacit
si i punëtorit
njësoj cicëron
zogu i kraharorit

Si i të kamurit
si i skamnorit
njësoj cicëron
zogu i kraharorit

Si n' fillim t' majit
si n' fund t' nëntorit
njësoj cicëron
zogu i kraharorit

Ushqeje zogun
me çokollatë
që të cicërojë
gjatë e më gjatë

E mjera çerdhja
që e braktis
cicërimë e zogut
në lule të rinisë!

TOKA MBAN DIETË

Eh, kjo Toka jonë, ky Planeti ynë
dikur rrotullohej lehtë si balerinë.

Sa dete ka pirë, sa ishuj ka ngrënë,
i ka humbur beli si gruas shtatzënë!

Në vrimën e fundit e mbërthen me zor,
rripin e belit të markës - “Ekuador!”

Tash është trashur, infarktiti i druhet,
për një rrotullim tërë dita i duhet!

Mjeku familjar i shkroi një recetë,
me barëra e këshilla veçse për dietë.

Të bëhet sërish e hollë dhe e gjatë,
si një manekine që del në sfilatë...

Që të rrotullohet prapë si balerina,
si Mihrije Braha dhe si – Adelina...

SHKOPI ME MAGJI

Epo, alkimistët, ishin njerëz të mirë,
tërë jetën ujitnin të vetmen dëshirë.

Urdhri hyjnor u thoshte në vesh:
“I kamur mund të jetë secili prej nesh!”

Sapo ta zbulojmë shkopin me magji,
çdo metal i prekur do të bëhet - flori.

Për këtë alkimistët po i bënin duatë,
të ishin të kamur, të jetonin gjatë...

Ndër laboratorë skuqnin epruveta,
po s’u ndizej fati, po s’u qeshte jeta.

Ca zëra tokësor prapë në vesh u thanë,
“Na i lini metalet ashtu sikur janë!

Me to do të vallëzojmë në metalurgji,
syresh do të fitojmë flori mbi floringj!”

Ç'THONË FËMIJËT?

Ç'pyll na qenka ai pyll,
ku s'bie natën asnjë yll?

Ç'fushë na qenka ajo fushë,
ku s'lodron asnjë drenushë?

Ç'det na qenka ai det,
ku asnjë anije s'shket?

Ç'qiell na qenka ai qiell,
pa surprizën - shi e diell?

Ç'kodër qenka ajo kodër,
ku s'kullot Arusha e Vogël?

Ç'lumë na qenka ai lumë,
që shelgjet nuk i kanë gjumë?

Ç'rrugë na qenka ajo rrugë,
ku makinat s'vënë më fugë?

Ç'poet qenka ai poet,
që s'na di për fëmijë të vet?

PRINDI NGA GJAKOVA

Paskësh pyetur një çun në Athinë:

“Ç’heroizëm bëri zonja - Heroinë?”

Paskësh pyetur një çupë në Llozanë:

“Nga na erdhi - zonja Marihuanë?”

Paskësh pyetur një djalë nga Parisi:

“A flet frëngjisht zotëri - Kanabisi?”

Paskësh pyetur një vajzë nga Pekini:

“Kujt i shërben zotëri - Johimbini?”

Ashpër u shpreh një prind nga Gjakova,

“Për këso vjershe s’ka nevojë Kosova!”

Shuk e bëri - në grusht e mbërtheu,

në njëmijë copë atë letër e shqeu!

NË OBORR TË SPASSES

Një herë, m'u ngjit një Hiç,
si ai i Sterio Spasses...

Ishte gjembaç e bullafiq,
mikrob i rritur tej masës.

Bëra gabim. Atë Hiç
e përkëdhela pak tepër...

Ai polli... U bënë dy miq,
një Hiç dhe një Hiç tjetër.

Dy Hiçët u shumëzuan
si kërpudhat në pranverë...

Kozmosin ma zvetënuan,
plot Hiçër e Hiçër të tjerë.

Kur pa në çfarë zori jam,
më tha një shok i klasës:

“Ktheji atje tek i more,
n'oborr të Sterio Spasses

Thuaji: S'më duhen Hiçët,
këto qenie të pamaterie...

Shokë e miq i kam - Diçët
që m'sjellin ylber pranvere!

KAVALIERËT TANË

Satirike

Detin e Kuq dhe Detin e Zi,
i sollën këta tanët në Arbëri.

“Kjo simbolikë ne na përket,
në tokë,
në qiell
edhe në det!”

Me xhentëlmencë të kavalierëve,
Detin e Vdekur ua lanë të tjerëve.

Që të mos ndihen humbës të thellë,
që të kenë
kripë
për plagë
dhe gjellë!

NJË MAL ME KËNGË

Agim Devës

Ti ke ecur përtej vetes,
ti ke ecur, ti,
Mirë i mësove rrugët e jetës,
mirë i mësove ti.

Këngës ison mirë ia mbajte,
mirë ia mbajte ti,
Ëmbël qeshe, hidhur qave
bashkë me Xhelën ti.

Botën n' sofër na e solle,
na e solle ti,
Zambakët e njomë i mbolle,
na i mbolle ti.

Globit namin ia ke rritur,
ia ke rritur ti,
Çun i mirë mjekërthinjur,
mjekërthinjur ti.

Një mal me këngë e mbëltove,
e mbëltove ti,
Zemrat e fëmijëve i gëzove,
i gëzove ti.

Këngës amën mirë ia gjete,
mirë ia gjete ti,
Mes fëmijësh fëmijë mbete,
Agim Deva, tiiiiiii!

STROFA E TRETË

Qahej gota me raki:

“Harbutes i plaçin sytë,
na erdhi droga jabanxhi,
na shtyri në ligë të dytë!”

“Mos u brengos asnjë pikë,
e trimëronte Coca-cola,
do të luajmë me taktikë,
do t’ia japim njëqind gola!”

Dy strofat i fshinë fëmijët,
e lanë veç të tretën!
E dinë ata kush i rritë.
Aty, shishe qumështi gjetën.

ÇKA I THASHË BABIT

I thashë babit pa të keq,
m'blej një deve katër vjeç,
blima dhe një shkretëtirë...
“Çfarë të duhen këto, bir?”

- Devenë dua ta shaloj,
si sheik mbi të t'udhëtoj,
një beduin do ta paguaj,
të na prijë tokës së huaj.
disa javë, a disa muaj...

Shkretëtirës do të shëtitem,
me pahitëse do të flladitem,
te një oazë kur të arrijmë,
n'hije palmash do të rrimë,
nga kaktusi ujë do të pimë.

Babi qesh e bën sehir...
“Zoti qoftë me ty, o bir,
do shkretëtirë në Dukagjin?!
Mirë që s'lyp dhe pinguinë,
t'i rritësh buzë lumit - Drin!”

Plasi gazi: Ha-ha-ha!
Qeshëm me germa të mëdha.
Mos ke dhe tjera dëshira?
Se s'po t'i zë shkretëtira!

MIRË E KEQ

Një Ufo prej Galaktike,
na solli lajme kozmike:

“Për fëmijët, në Jupiter,
në vend borës resh sheqer,
në vend ujit rrjedh limonadë,
në vend bukës hanë çokollatë!”
Lakmoi Astriti e tha,
“Oh, sa mirë!
Të lumtë ata!”

Prapë ai zëri nga raketa,
thuri – shturi fjalët e veta:

“Jo sa mirë, por, sa keq,
dhëmbët e prishur si pleq,
të nëpërkëmbur shëndetin,
tym për tym me diabetin!”
Ç’lakmoi Astriti e tha,
“Oh, sa keq!
Të mjerët ata!”

Ufo-ja sa shpejt u zhduk,
në drejtim të Jupiterit...
Prapë Astriti do të hajë bukë
me kajmak, n’vend t’ sheqerit.

PSE NUK JEMI SI ATA

Në Galaktikën - RrokokoPO,
gjendet Yllësia - RrokokoJO,
në atë Yllësi është një Planet,
n'atë Planet është një Kontinent,
n'atë Kontinent gjendet një Shtet,
dhe,

Në atë Shtet është një Qytet,
pak më i madh se Gjirokastra,
me rrugë dhe sheshe të pastra,
pak më i vogël se Uashingtoni,
me shkëlqimin që ju ëndërroni.

Nëpër kuartet e atij Qyteti,
t'atij Qyteti, të atij Shteti,
të atij Shteti, t'atij Kontinenti,
të atij Kontinenti, t'atij Planeti,
të atij Planeti, të asaj Yllësie,
që ka "pasvordin" me katër yje,
jetojnë krijesa tepër të mira,
shtëpitë stolisur me xhevahire,
rrugët shtruar ngjyrash t'ylberta,
zemrat humane, sjellje t'sinqerta
nuk mbahet mend krim as hajni,
kurrë në mes tyre s'pat hasmëri...

E lexoi Elsa këtë vjershë e tha,
"Pse nuk jemi edhe ne si ata?!"

FSHATI IM

Në planetin tonë
s'ka fshat si ai...
Në planetët tjerë
ndoshta...Kushedi!

Te këmbët e Zhlebit
perlë e Dukagjinit...
Ylberi pi ngjyrat
në ujëvarë të Drinit.

Çelin lulet, krojet
si syri nën vetull...
Pylli i rrit lisat,
me diell e mjegull.

Cicërojnë ferishtet
si zogj nëpër çerdhe...
Pllajat e pemishtet
të thonë: - Mirë se erdhe!

Eja rri ndonjë ditë,
në fron Perëndish...
Qerasi mushkëritë
me - ozon lartësish.

SI U RRIT KROI

Kur isha fëmijë
me quanin – Krua

Djalosh kur u bëra
më thonin – Përrua

Fuqia me shtohet
për ditë e më shumë

Në kostum burrash
me thërrisnin – Lumë

Më të plakur cazë
me pagëzuan – Det

Pleqërinë e thellë
rrallë kush e pret

Ata që e presin
privilegj e kanë

Në vend babagysh
u thonë – Oqean

DEMITIZIM

Buburreci tërë jetën punoi,
buburrec ai mbeti përsëri...

Majmuni me majmunllëqe,
sipas Darvinit, u bë - Njeri.

Kështu disi, thoshte përralla,
kultin për punë e demitizoi...

E dalldisur u shpreh gjinkalla,
“Me orkestër tash do të këndoj!”

NGA, KY DUF?

Lisat nuk më shkulen,
Bjeshkët s'më përkulen...
- Nga kjo kryeneçësi?

Me zgërdhijnë sheshet,
Don Kishoti më qeshet...
- Pse kjo poshtërsi?

Shkurti ma vjedh prillin,
shelgjet ma zënë diellin...
- Si t'ia bëj s'e di?

Në udhëkryq me të hyrë,
semafori s'më kish ngjyrë...
- Ç'është kjo pabesi?

U nisa për në katund,
po nuk arrita askund...
- Vaj për dajët e mi!

Muzgu ma fsheh agun,
Porta ma ngrit pragun...
- Si të dal në liri?

Nga, ky duf ndaj meje?
Mos, pse jam prej Peje?!
- Nejse! S'ka rëndësi!

